



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA**



PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“RËNDËSIA E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË
FORMIMIN AKADEMIK”**

**FINANCUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR
VITIN AKADEMIK 2022-2023**

Ekipi i projektit:

Prof. Asoc. Dr. Eglantina GISHTI (koordinatore)

Prof. Asoc. Dr. Alba FRASHËRI

Dr. Fjoralba DADO

Rezulate të Projektit

Projekti me titull “Rëndësia e Inteligjencës Artificiale në formimin akademik” u propozua në përgjigje të thirrjes për projekte të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, bazuar në Urdhër të Ministrit Nr. 360 datë 28.06.2022 “Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2022-2023” dhe u shpall fitues me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 468, datë 02.08.2022 dhe me shkresën Nr. 2203/5 Prot., datë 05.08.2022 të UT-së.

Projekti "Rëndësia e Inteligjencës Artificiale në formimin akademik" është propozuar në vijim të bashkëpunimit me Universitetin Sorbonne Paris Nord (USPN), në fushën e Inteligjencës Artificiale, specifikisht në Trajtimin Automatik të Gjuhëve si nëndegë e saj.

Qëllimi kryesor i i projektit është zhvillimi i diplomës së dyfishtë Master, i vetmi në këtë fushë:
Masteri në Trajtimin informatik dhe gjuhësor të dokumenteve të shkruara



DIPLOMË E DYFISHTË

MASTER I SHKENCAVE
UNIVERSITETI I TIRANËS
dhe
UNIVERSITETI SORBONNE PARIS NORD, FRANCË
ofrojnë diplomën e dyfishtë
Fusha : **TRAJTIMI AUTOMATIK I GJUHËVE**
Drejtimi: **TRAJTIMI INFORMATIK DHE GJUHËSOR I DOKUMENTEVE TË SHKRUARA**

Nëse doni :

- të familjarizoheni me Inteligjencën Artificiale,
- t'i mësoni kompjuterit si të trajtojë materialin gjuhësor duke e shndërruar këtë të fundit në të dhëna,
- të mësoni si të nxirni automatikisht kuptimin nga teksti, si të krijoni chatbots*, si të ndërtoni rrjete neuronale (neural networks) apo si të përdorni të dhënat gjuhësore në sisteme informatike të dedikuara,

... kjo është rruga e duhur për ju!

Studentët do të :

- pajisen me diplomë të dyfishtë nga Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Sorbonne Paris Nord ;
- ndjekin studimet e vitit të dytë në Universitetin Sorbonne Paris Nord,
- zhvillojnë praktikën në Francë, në ndërmarrjet me të cilat USPN ka marrëveshje.

Programi mësimor është i njëjtë me atë të Masterit në **Universitetin Sorbonne Paris Nord** dhe do të zhvillohet nga profesorët e **USPN**, profesorët e **Fakultetit të Gjuhëve të Huaja** dhe të **Fakultetit Ekonomik** i UT-së, i cili është pjesë e bashkëpunimit të krijimit të diplomës së dyfishtë.

*Program kompjuterik i cili stimulon komunikimin njerëzor duke përdorur Interligjencën Artificiale dhe Trajtimin Automatik të Gjuhëve .

Koordinatori akademik :
eglantina.gishti@unitir.edu.al
Regjistrime : Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Sekretaria Mësimore e Masterave.

Ecuria e Diplomës së dyfishtë viti akademik 2022-2023

Aplikimet dhe regjistrimet u zhvilluan mbështetur në legjislacionin shqiptar, sipas afateve të përcaktuara.

Pas përzgjedhjes së fituesve nga një komision i përbashkët i të dyja universiteteve u miratua lista e fituesve dhe rezultuan fitues 14 studentë, të cilët u regjistruan në vitin e parë. Studentët shqiptarë kaluan procesin e intervistave me stafin pedagogjik të Universitetit Sorbonne Paris Nord.

Aktualisht, studentët shqiptarë kanë përfunduar regjistrimin pedagogjik në Universitetin Sorbonne Paris Nord dhe janë duke përfunduar regjistrimin administrativ (bazuar në rregulloren e Universitetit Sorbonne Paris Nord).

Universiteti partner ka dërguar listën e 18 studentëve francezë që dëshirojnë të regjistrohen dhe të ndjekin studimet në Universitetin e Tiranës. Lista e studentëve u dërgua në QSHA për pajisjen e tyre me numër matriculimi.


Studentët kanë zhvilluar leksionet rregullisht që prej fillimit të vitit akademik, 7 nëntor 2022. Programi mësimor është i njëjtë me atë të Masterit në Sorbonne Paris Nord. Bazuar në Marrëveshjen e Zbatimit, lëndët zhvillohen nga pedagogë shqiptarë dhe francezë. Lëndët si Informatikë dhe Gjuhësi (anglisht) zhvillohen nga profesorë shqiptarë. Lëndët e Modulit Inxhinieri Gjuhësore dhe Njohuri Shkencore mbulohen nga stafi francez, sepse këto lëndë kërkojnë një formim ndërdisiplinor (informatikë dhe gjuhësi).

Paralelisht janë zhvilluar trajnime të stafit të përfshirë në diplomën e dyfishtë (me fondet e projekteve të UT së 2021-2022) të cilët u zhvilluan sipas parashikimeve në muajin shkurt 2023.



Për realizimin sa më mirë të procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit, u gjykua e nevojshme **krijimi i një Laboratori Kërkimor** (i ngjashëm me atë në USPN) me logjistikën e duhur hardware dhe software. Laboratori ka pajisje të reja si: kompjuter, laptopë, projektorë, tabelë interaktive si dhe pajisje të tjera të nevojshme për një funksionim sa më të mirë dhe efikas.

Në fund të vitit 2022 u realizuar ngritja e laboratorit kërkimor: “**Trajtimi Automatik i Gjuhëve**”.



Ecuria e Masterit

Diploma e përbashkët master me USPN ka 39 studentë të regjistruar: 20 viti 2 dhe 19 viti 1, nga të cilët: 18 janë studentë francezë që do të pajisen me diplomë të UT-së; 5 studente ndjekin vitin e dytë të studimeve në Francë me mbështetje financiare nga Programi Erasmus+ KA171 dhe një bursë nga Ambasada e Francës në Shqipëri.

Në vitin akademik 2023-2024 diplomohet brezi i parë i studentëve të këtij masteri.